

1

**REPUBLIKA E KOSOVE  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLICA OF KOSOVA**

C.nr.199/2010

**GJYKTA THEMELORE MITROVICE** (ne objektin e deges se kesaj gjykate ne Vushtrri), gjyqtari Skender Shala, me qeshtjen juridike kontestimore te paditeses - Prishtine, te cilen e përfaqeson i autorizuari sipes autoizimit me shkrim, kunder te paditurit nga Mitrovica rr., nr. per borxh, ne seancen pergatitore te mbajtur me dt.29.11.2013, ne prezence te te autorizuarit te paditeses, e ne mungese te te paditurit, bie kete:

**A K T G J Y K I M   P E R   S H K A K**  
**T E   M U N G E S E S**

**APROVOHET** kerkespadia e paditeses e bazuar dhe **OBLIGOHET** i padituri nga Mitrovica Rr., nr. qe ti paguaj paditeses ne emer te borgjut shumen prej 243,84 Euro, me kamate prej 3.5%, te cilen e paguajne bankat komerciale duke filluar nga dita e parashtrimit te padise e deri ne diten e pageses definitive si dhe shpenzimet e procedures kontestimore ne shume prej 30 euro, ne afat prej 7 ( shtate) ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, nen kercenim te permbarimit te dhunshem.

**A r s y e t i m**

Paditesja permes te autorizuarit te saj ka ushtruar padi ne kete gjykate dhe ka kerkuar qe gjykata ta obligoj te paditurin qe paditeses t'ia paguan shumen prej 243,84 Euro, me kamat ligore prej 3.5%, duke filluar prej dates se parashtrimit te padise e gjere ne diten e pageses definitive si dhe t'ia paguaj shpenzimet e peroedures kontestimore.

Gjykata caktoj seancen e shqyrtimit pergatitor per dt. 29.11.2013, ne ora 10 :00 dhe per kete palet kane qene te ftuara me rregull. Ne seance prezentoj i autorizuari i paditeses kurse i padituri edhe pse eshte ftuar me kohe dhe ne menyre te rregullt, i njejt i nuk i'u per gjigji fteses dhe nuk prezentoi ne seance gjere ne perfundimin e saj dhe mungesen nuk e ka arsyetuar, qka u konstatua ne baze te fletektheses te kthyer nga sherbimi postal i dorezimit te kesaj gjykate e dt. 11.11.2013 dhe nuk e ka kundershtuar me parashitrese kerkespadine e paditeses.

Ne kete séance i autorizuari i paditeses propozoj Gjykates qe seanca te mbahet ne mungese te te paditurit, per shkak se i njejti eshte ftuar me kohe dhe ne menyre te rregullt dhe mugesen nuk e ka arsyetuar si dhe te bie akgjykim per shkak te mungeses.

Me qenese kerkespadija bazohet ne fakte te cekura ne padi, ndersa keto fakte nuk jane ne kundershtim me provat te cilat I autorizuari i paditeses i ka prezantuar, gjykata gjeti se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi e konform nenit 151.1 te Ligjt per proceduren kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore u muar konform nenit 452.1 te LPK-se, ashtu qe te paditurin e obligoj qe paditeses tia paguaj shpenzimet e procedures kontestimore dhe ate taksen per padi dhe vendim gjyqesor, shumen prej 30 euro, konform Udhezimit Administrativ te KGJK per Tarifat e Taksave Gjyqesore nr. 2008/02.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**C.nr.199/10, te dt.29.11.2013.**

**Gjyqtari,**  
**Skender Shala**

**KESHILLE JURIDIKE :**Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

**Saktesine e pershkrimit e verteton:**

18.01.2011



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.95/2010

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE.** Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshjen juridike te paditesit: nga fsh Mitrovices, te cilin e perfaqson Avokat sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve; vajzërisë te gjithë nga fsh., Komuna e Mitrovices, baza e kontestit; Vertetim pronesie, vlera e lendet se kontestit; 2.500,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.24.12.2015, jep kete;

**A K T G J Y K I M**

- APROVOHET kerkespacia e paditesit: nga fsh. Zhabar, dhe VERTETOHET se paditesi eshte pronar i palujteshmerise , parc.kat. 83 me kulture livadhe klasa e 3 me sipërsaqe prej 0.09,27 ha ne vendin e quajtur „ Zhute njive – Livadhi te kershi „ , parc.kat.157 me kulture are e klasës se trete me sipërsaqe prej 0.01.92 ha ne vendin e quajtur „ Selishte te Bunari,, si dhe pjesës se parc. kat . 402 me kulture are e klasës se trete ne vendin e quajtur „ Perzhina Kry Jazi,, me masa dhe kufij qe janë shënuar ne skicën e terenit te ekspertizës ne sipërsaqe prej S = 2221 m<sup>2</sup> , te cilat evidentohen ne emër te Karaqa Emine ¼, Shqiptar Sadiku ¼, Qazim Sadiku ¼ dhe Osman Sadiku ¼ ZK Zhabar i Eperm.

Detyrohen te paditurit qe ti njohon kete te drejte paditesit dhe ti lejoj qe paditesi kete palujteshmeri ta regjistroi ne emër te tij pranë Drejtorisë per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovice, ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditesi ne padin e tij si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ka dheksuar se: paditesi me tanin te ndjerin - babain e te paditurit te pare  
me dt. 10.02.1980 si dhe me ' - babain e paditesit te dyte  
tanin te ndjerin me dt. 20.04.1979 kane dhene kontribuimin bi shitblerjen e palujteshmerive te cekur ne dispozitiv te këtij aktgjykimi me tanin te shitblerjes prej 5.000.000 dinare



dhe 4.500 DM dhe 2.000.000 dinare te cilin qmim ne tërësi iu ka paguar shitësve me rastin e shitblerjes e te cilën e shfrytëzon edhe tani pa pengesa nga askush , mirëpo per shkak te neglizhencës nuk eshte bartur ne emër te paditësit .

Ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kërkesëpadisë ta aprovoj ne tërësi si te bazuar nga se i njëjtë eshte pronar ne baze te shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata seancën e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te paditurve , konform nenit 423. 4 te LPK-es

Te paditurit dhe ne seancën pregaditore e pohuan ne tërësi kërkesëpadinë e paditësit si te bazuar.

E paditura me parashtresen e saj me shkrim te dt. 11.11.20154  
dhe i padituri me parashtresën me shkrim te dt. 12.11.2015 e kane  
pohuar ne tërësi kërkesëpadinë e paditësit si te bazuar.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Qertifikatat e pronësisë – Njesia katastrale P-00402-0 , P-00083-0, P-00157-0 te dt. 06.11.2015 , Lexoi ekspertizën e ekspertit gjeodet e dt. 06.11.2015, beri vështrimin ne skicën e terenit te dt. 05.11.2015 Lexoi procesverbalin mbi vendshiqim te kësaj gjykate te dt. 30.11.2015 dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Qertifikatat mbi te drejtat e prones se palujtshme te cekura me larte , konstatohet se palujteshmeria tani lendore evidentohet ne emër te pronareve sikurse qe eshte cekukr ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; palujtshmeria tani lendore shtrihet dhe evidentohet ne parc kat. te cekura si ne dispozitiv.

Nga skica e terenit shifet shtrirja-siperfaqja si dhe perkufizimi i palujtshmerive tani lendore.

Nga procesverbali mbi këqyrjen ne vend i kësaj gjykate konstatohet: se gjyqtari me vrojtim te drejteperdrejte ne vend konstaton se : palujteshmerite tani lendore janë te përkufizuara fizikisht me shenja te perkufizimit

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerit tani lendore paditësi i ka blaere nga shitësit Mursel babai i - babai i paditësit te pare



paditësit te dyte dhe ate nga shitësi me qmim te shitblerjes  
prej 5.000.000 plus 4.500 DM ndërsa nga shitësi ka blere palujtshmerine  
tani lendore me qmim prej 2.000.000 dinare te cilin qmim paditësi iu ka paguar  
menjëherë shitësve me rastin e shitblerjes dhe ka hyre ne disponim dhe shfrytëzim te lire  
te kësaj palujtshmerie te cilën e ka shfrytëzuar pa pengesa qe nga shitblerja e gjere me  
tani .

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr.  
O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne  
posedim te panderper një palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes , paditesi e ka ne shfrytzim dhe  
disponim te lire keto palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush.  
Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze  
te mbajties e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i  
papengushem i kesaje palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se keto palujtsheri paditësi e ka blere nga i ati i te  
pditurit te pare dhe te dyte .

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesi e ka blere keto  
palujtshmeri qe nga vitin 1979 – 80 .

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytzim  
te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie, gjer me tani. Prandaj gjykata  
konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit  
me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**C nr.95/2010 dt.24.12.2015**

G j y q t a r i,  
Ragip Kadriu



**KESHILLE JURIDIKE;** Kunder ketije aktgjykimi mundë te ushtrohet ankesa ne  
afatin prej 15 diteve nga ditja e pranimit, Gjykates se  
Qarkut ne Mitrovica e permës kesaje gjykatë.

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ESHTË I PLOTFUQISHËM Saktsin e pershkrimit e verteton;  
ODLUKA JE KRAVNOSNAZNA S. Hoxha  
GJYKATA THEMELORE I OSNOVNI SUD  
MITROVICE - MITROVICA

Me  
Dana 05.02.2016